VENDIM
Nr.1052, datë 22.7.2008

PËR LEJIMIN E KALIMIT TRANZIT TË TRI AUTOKOLONAVE USHTARAKE ITALIANE, PËRMES TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16, pika 2, 17, 18 e 19 të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 "Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit", me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, të një autokolone ushtarake italiane, të përbërë nga 5 (pesë) automjete dhe 10 (dhjetë) trupa, në itinerarin Qafë-Thanë-porti i Durrësit, në datën 22 korrik 2008.

2. Lejimi i kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, të një autokolone ushtarake italiane, të përbërë nga 1 (një) automjet dhe 2 (dy) trupa, në itinerarin porti i Durrësit-Qafë-Thanë, në datën 24 korrik 2008.

3. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, të një autokolone ushtarake italiane, të përbërë nga 4 (katër) automjete dhe 8(tetë) trupa, në itinerarin porti i Durrësit-Qafë-Thanë, në datën 28 korrik 2008.

4. Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë, në datën 22 korrik 2008, të jetë pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë dhe pika e daljes porti i Durrësit.

Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë, në datat 24 e 28 korrik 2008, të jetë porti i Durrësit dhe pika e daljes pika e kalimit Qafë-Thanë.

5. Procedurat për hyrjen, qëndrimin dhe daljen e këtyre trupave në Republikën e Shqipërisë janë parashikuara në marrëveshjen, ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut, për statusin e forcave nënshkruar në Londër, më 19 qershor 1951, të marrëveshjes, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe shteteve të tjera, që marrin pjesë në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre, nënshkruar në Bruksel, më 10 janar 1994, si dhe të protokollit shtesë, për marrëveshjen, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe të shteteve të tjera pjesëmarrëse në Partneritetin e Paqes, për sa i përket statusit të forcave të tyre", ratifikuar me ligjin nr.8034, datë 22.11.1995.

6. Autokolonat ushtarake italiane, gjatë itinerarit të lëvizjes nëpër territorin e Republikës së Shqipërisë, të shoqërohen nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

7.Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare

KRYEMINISTRI
Sali Berisha